

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-207/13**

**Prishtinë, 21 janar 2014**

Në çështjen e:

**D. N.**  
Vushtrri

***Ankuesi***

kundër

**M. M.**  
Mitrovicë

***Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Ermenkova-Filcheva, Kryetare e kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, anëtar të kolegjit, duke vendosur me ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/176/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA10681), i datës 24 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 21 janar 2014, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/176/2002 (për aq sa ka të bëjë me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA10681), të datës 24 tetor 2012.
2. Kërkesa për pronën private e M. M. për aq sa ka të bëjë me kërkesën e regjistruar me numrin KPA10681 hedhe për shkak të mungesës së jurisdikcionit.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 28 qershor 2006, M. M.ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) me të cilën kërkonte që ai të njihej si pronar i objektit komercial që gjendet në Mitrovicë, në Rr."Ivo Lolla Ribar nr. 14, në sipërfaqe prej 34 m<sup>2</sup>. Këtë objekt komercial e ka blerë nga B. Xh. sipas kontratës së shitblerjes Vr.nr.65/05 me dt. 14 janar 2005 dhe se ai asnjëherë nuk ka hyrë posedim të këtij objekte, ngase i njëjti është okupuar nga pala përgjegjëse në kërkesë. Posedimi për këtë pronë të paluajtshme e ka humbur B. Xh. si rezultat i rrethanave në Kosovë në vitin 1998/1999.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP këto prova shkresore edhe atë:
  - a. Kontratën e shitblerjes vr.nr.65/05 i dt.14 janar 2005 ,metë cilën me nenin 1 konstatohet se shitësi B.Xh. i shet blerësit M. M. pjesën e lokalit-pasazhit që gjendet në Mitrovicë në rr."Ivo Lola Ribar,S-3 në sipërfaqe prej 18 m<sup>2</sup> prej sipërfaqes së përgjithshme prej 34m<sup>2</sup>,
  - b. Aneks kontratën vr.nr.842/11e dt. 26 maj 2011,
  - c. Kontratën e shitblerjes i dt.18.shkurt 1993.Këto kontrata janë verifikuar pozitivisht.
3. Më 28 dhjetor 2007 AKP ka bërë njoftimin në lidhje me kërkesën duke e vendosur një shenjë në vendin ku supozohej se ndodhej objekti komercial e me ç rast ka konstatuar se ajo është pronë komerciale dhe është në posedim të palës përgjegjëse në kërkesë.
4. KKPK me vendimin KPCC/D/C/176/2012 të datës 24 tetor 2012 ,ka miratuar kërkesën e M.M. ,duke vendosur se ai kishte dëshmuar se është titullar i së drejtës pronësore i objektit komercial që gjendet në rr."Ivo Lolla Ribar"nr14 ,pasazhi i ndërtesës S-3,në Mitrovicë ,duke i pranuar edhe të drejtën e posedimit.
5. Me datën 29 maj 2013 vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës.

6. Me datën 05 korrik 2013, N. D. (nga tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur një ankesë në AKP, ku theksonte se me Aktgjykimin AC.nr. 111/2006 të datës 08 maj 2006 i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë C.nr.356/2005 i dt.14 nëntor 2005. Kjo, me arsyetimin se me kontratën e lidhur me 18 shkurt 1993, B.Xh.e ka blerë lokalin –pasazhin të përcaktuar në nenin një të kësaj kontrate në sipërfaqe prej 18 m<sup>2</sup>, nga E.S., prandaj ai nuk ka mundur t’ia shes atë lokal në sipërfaqe prej 34 m<sup>2</sup> M. M.. Po kështu sipas padisë së paditësit M. M. për pengimin e posedimit në lokalin afarist që është objekt i këtij kontesti, Gjykata Komunale në Mitrovicë me aktvendimin C.nr. 137/2005 i dt. 09.mars 2005, ka refuzuar kërkesëpadinë e tije si të pabazuar duke konstatuar se i padituri nuk e ka penguar në posedimi paditësin
7. Me dt. 17 tetor 2013 ankesa i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (nga tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) dhe se i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

#### **Arsyetimi ligjor:**

8. Ankesa është e pranueshme.
9. Sipas Nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, të amendamentuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave të cilat lidhen me pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu pronën bujqësore dhe atë komerciale, pala mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit mbi vendimit.
10. Sipas raportit të notifikimit i dt. 28 dhjetor 2007 është identifikuar pala përgjegjëse në kërkesë-ankesë por ajo nuk është njoftuar me vendimin e KKKPK, ndaj ankesa është e pranueshme. Kjo rrethanë e mos njoftimit e vendimit të KKKPK nuk mund të shkojë në dëm të palës ankuese pasi që në të vërtetë ai nuk është njoftuar lidhur me vendimin ankimor dhe se ai ka interes ligjor në këtë çështje juridike të vërtetimit të pronësisë sipas parashtruesit të kërkesës.
11. Gjykata Supreme konkludon se vendimi ankimor i KKKPK është marr me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 182 par 2 nëpar b të LPK-ës dhe nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, të cilat shkelje janë të natyrës absolute e për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Prandaj mbi këtë bazë juridike vendimi ankimor anulohet duke hedhur kërkesën e paraqitësit të kërkesës për shkak të mungesës së juridiksionit të kësaj gjykate dhe rrjedhimisht të KKKPK-ës sipas dispozitës së nenit 198 par 1 të LPK-ës.
12. Sipas Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ri-posedim të pronës nëse

- paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e dëshmon pronësinë mbi pronën por edhe që ai apo ajo tani nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat ndaj asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
13. Është e vërtetuar që Gjykata së Qarkut në Mitrovicë me aktgjykimin e saj AC.nr.111/2006 ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Mitrovicës C.nr.356/2005 i dt.14 nëntor 2005. Kjo, me arsyetimin se B. Xh. kishtë blerë lokal-in-pasazhin nga E.S, ashtu siq është cekur në nenin I të kontratës së lidhur me 18 shkurt 1993, në sipërfaqe prej 18 m<sup>2</sup>, Prandaj, B. XH. nuk ka mundur asnjëherë ta shesë lokal-in e Milorad Mitrović-it, në sipërfaqe prej 34 m<sup>2</sup>.
  14. Për më tepër, sipas kërkesës së paraqitësit të kërkesës M. M. për pengim posedimin e lokalit afarist., Gjykata Komunale në Mitrovicë me aktvendimin C.nr. 137/2005 i dt. 09.mars 2005, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit M.M. si të pabazuar duke konstatuar se i padituri G. N. nuk e ka penguar në posedim paditësin në pronën e paluajtshme që është objekt i kësaj çështje juridike. Sipas padisë së paditësit M. M. por edhe nga procesverbali i seancës kryesore të Gjykatës Komunale në Mitrovicë C.nr.137/2005 i dt.9 mars 2005, thekson se lokal-in afarist nga neni një i kontratës së shitblerjes së paluajshmërisë vr.nr.65/05 i dt.14.janar 2005, deri më 15 janar vetë e ka pasur në posedim e pas kësaj date të njëjtin e shfrytëzon N.G. Prandaj, me pa mëdyshje rezulton se paraqitësi i kërkesës nuk paraqiti prova juridikisht të vlefshme se është zhvendosur nga prona e kërkuar apo e ka humbur posedimin dhe kontrollin mbi pronën e tillë si pasojë e konfliktit në periudhën kohore 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Madje nga procesverbali i seancës kryesore të Gjykatës Komunale në Mitrovicë C.nr.137/2005 i dt.9 mars 2005 ,thekson se lokal-in afarist të kërkuar e ka pasur në posedim deri më 15 janar. Nga kjo datë të njëjtin e shfrytëzon ankuesi.
  15. Pra ,meqenëse paraqitësi i kërkesës nuk dëshmoi pronësinë që ai është pronar i pronës së kërkuar dhe rrjedhimisht nuk vërtetuan faktin se nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat të asaj prone për shkak të rrethanave që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999, prandaj sipas dispozitës së n Nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, kjo çështje juridike nuk është në juridiksionin e KPPC dhe rrjedhimisht të Gjykatës Supreme.
  16. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen vendimi ankimor i KKPK-së meqë është jashtë juridiksionit prandaj i njëjti është dashur të anulohet dhe kërkesa të hedhet poshtë (neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

## Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta dhe ato jashtëzakonshme juridike.

*Elka Ermenkova-Filcheva,, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Willem Brouwer, Gjyqtare e EULEX-it*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Urs Nufer, Referent i EULEX- it*